



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:199081
Datë: 19.02.2025
Numri i dokumentit: 06870439

C.nr.2759/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Vegim Maloku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.D. nga fshati N., Komuna e Pejës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A. Nikqi, avokat në Pejë, kundër të paditurit S. Gj. nga Peja, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë Mustafë Kastrati dhe Valon Kastrati, avokat në Pejë, me bazë juridike: pengim posedimi, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe publik me datë 06.02.2025, mori, ndërsa me datë 19.02.2025 bie këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET në tërësi e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit M. D, nga fshati N., Komuna e Pejës, me të cilën ka kërkuar që të VËRTETOHET se i padituri e ka penguar paditësin M.D. në posedimin dhe shfrytëzimin e paluajtshmerisë e cila shtrihet në parcelat nr.253-1 me sipërfaqe prej 380 m² dhe nr.253-37 në sipërfaqe prej 448 m², ZK Kuqishtë, Komuna e Pejës, e në të cilën paditësi ka objektin e banimit (stanin), në atë mënyrë që para dhe deri më tani me datë 27.08.2023 me eskavator kanë hapur ‘rrugë’ nëpër paluajtshmerinë që paditësi e ka në posedim, në gjerësi prej 3-4.5 m dhe gjatësi prej 57.90 m nga pika 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36 dhe 37 në pjesën e parcelës nr.253-37 duke vazhduar edhe në pjesën e parcelës nr. 253-1 në gjerësi prej 3-4.5 m në gjatësi prej 39.24 m, në sipërfaqe të përgjithshme prej 204 m², ka rrafshuar këtë pjesë të tokës për ndërtim, ndërsa në anën jugore, kufiri lindje perëndim, ka vendosur një gardh prej druri nëpër pikat 8,9,10,11,12 dhe 13 duke ja hequr nga posedimi një pjesë të tokës që paditësi e ka pasur në posedim dhe të DETYROHET i padituri që në afat prej 7 ditësh të kthej në gjendje të mëparshme të para datës 27.08.2023, përfshirë heqjen e gardhit të cekur në pikën II, dhe në të ardhmen të mos pengoj paditësin M.D. në paluajtshmerinë e lartcekur të cilën e ka në posedim dhe shfrytëzim, si dhe të OBLIGOHET i padituri që paditësit të ia paguaj të gjitha shpenzimet

procedurale sipas tarifës së OAK-së e në lartësi prej 1530 euro e këtë në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi e nën kërcenim të përmbarimit.

II. DETYROHET paditësi M. D, që të paditurit S. Gj., t'ia paguaj shpenzimet procedurale në shumën prej 846.50 €, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, e nën kërcenim të përmbarimit ligjor.

Arsyetim

I. Historiku i procedurës

Paditësi M. D, nga fshati N., Komuna e Pejës, të cilën e përfaqëson A. Nikqi, avokat në Pejë, kundër të paditurit S. Gj., nga Peja, ka ngritur padi kundër të paditurit me bazë juridike: pengim posedimi.

I autorizuari i palës paditëse, me parashtresën e datës 11.06.2024, ka bërë precizimin e padisë në aspektin subjektiv dhe objektiv, ku ka theksuar se në seancën e realizuar në terren, në vendngjarje ka prezantuar edhe K. Gj., prandaj i njëjti ka hequr dorë nga thirrja e S. Gj. dhe G. Gj. si të paditur, dhe si palë të paditura ka përfshirë S. Gj. dhe K. Gj., këtë parashtresë për precizim nga pala paditëse e ka kundërshtuar pala e paditur me parashtresë të datë 18.06.2024, ku ka theksuar se sa i përket zgjerimit të padisë në kuptimin subjektiv në raport me K. Gj., duhet të merret pëlqimi i tij se a pranon që në këtë fazë të procedurës të jetë palë në procedurë, ndërsa sa i përket tërheqjes së kërkesëpadiisë në raport me S. dhe G. Gj., të njëjtën nuk e ka kundërshtuar, tërheqjen e kërkesëpadiisë në raport me S. dhe G. Gj. gjykata e ka lejuar me aktvendim në procesverbalin e datës 09.09.2024.

I autorizuari i palës paditëse me parashtresën e datës 11.09.2024, e ka bërë precizimin e kërkesëpadiisë në kuptimin objektiv, i cili precizim është lejuar nga gjykata me aktvendim në procesverbalin e datës 06.02.2024, ndërsa në lidhje me propozimin e palës paditëse që të lejohet zgjerimi i padisë në aspektin subjektiv ndaj të paditurit K. Gj., gjykata me anë të njoftimit i është drejtuar K. Gj., me të cilin është njoftuar se a pranon që të marrë pjesë në procedurë si palë e paditur, i njëjti me parashtresën e datës 07.11.2024, e parashtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar nga gjykata përmes të autorizuarve të tij Valon dhe Mustafë Kastrati, ka deklaruar se nuk e jap pëlqimin që në këtë fazë të procedurës të zgjerohet padia ndaj tij dhe nuk pranon që marrë pjesë në këtë procedurë. Lidhur me këtë çështje gjykata ka vendosur me aktvendim në

procesverbalin e datës 06.02.2024, ku e ka refuzuar propozimin për zgjerimin e padisë në aspektin subjektiv tek K. Gj., për shkak se i njëjti nuk ka dhënë pëlqimin që të zgjerohet padia ndaj tij në këtë fazë të procedurë, dhe është theksuar se tani e tutje palë paditëse në këtë procedurë është M.D.kurse palë e paditur mbetet vetëm S. Gj.. Sipas nenit 264.2 të LPK-së, në mënyrë që të lejohet zgjerimi i padisë tek personi tjetër, duhet të merret pëlqimi i këtij të fundit, e që për gjykatën kjo paraqet dispozitë ligjore imperative, e të cilën gjykata nuk mundet që ta tejkaloj, për shkak se nuk kemi ndryshim të padisë, sepse tek ndryshimi i padisë, kemi të bëjmë vetëm sa i përket ndryshimit të njëjtësisë së kërkesëpadisë, zmadhimi i kërkesëpadisë apo parashtrimi edhe i një kërkesë tjetër krahas asaj ekzistuese sipas nenit 257 të LPK-së. Pra, ligji në fjalë, bënë dallimin sa i përket këtyre dy situatave, ashtu që tek zgjerimi i padisë tek personi tjetër, është kusht ligjor pëlqimi i këtij të fundit, e të cilën gjykata nuk mundet që ta tejkalojë dhe kemi të bëjmë me aspekt subjektiv (personin) kurse tek ndryshimi kemi të bëjmë me objektin, respektivisht kërkesën.

II. Pretendimet e ndërgjyqësve

Paditësi me padi dhe gjatë seancave ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, si dhe precizimit të datës 11.09.2024, tutje ka shtuar me datë 27.08.2023, kanë rënë në dijeni se tani të paditurit pa dijeninë e paditësit, me eskavator kanë hapur rrugë dhe kanë rrafshuar bazamente për ndërtim në parcelën nr.253-37 ZK Kuqishtë, ku pretendon se paraprakisht të njëjtit kanë vendosur një gardh prej druri me të cilin janë afruar vetëm disa metra afër stanit të paditësit dhe duke i'a kufizuar oborrin e stanit (objekt nga druri). Paditësi ka provuar që të merret vesh me të paditurin në mënyrë që të mos ti shkaktojnë pengim të posedimit në këtë pjesë të ngastrës, ngase i njëjti e ka në posedim dhe po ashtu është në procedurë gjyqësore për vërtetimin e pronësisë për ngastrën në fjalë. Tutje ka shtuar se të paditurit me veprimet e tyre në terren, ndërhyrjet me eskavator janë duke e krijuar një unazë të ndërtimeve me të cilat do të zvogëlohet sipërfaqja e cila është në posedim të paditësit dhe tashme kemi të bëjmë me pengim posedim. I njëjti shton se në bisedë e tij bashk me vëllain, i padituri S. Gj. u ka thënë që mund të i drejtoheni gjykatës për këtë çështje, duke konfirmuar kështu që më nuk ka vend për marrëveshje në mes të palëve. Gjatë shqyrtimit ka theksuar se akti i posedimit ka të bëjë kryesisht me shtruarjen e një rruge të re nga ana e të paditurit afër stanit – objektit prej drurit të palës paditëse saktësisht kjo rrugë është shtuar nëpër oborrin e këtij stani të cilin paditësi me familjen e tij e ka shfrytëzuar për dalje në natyrë gjatë vikendeve. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se konsideron që në këtë procedurë gjyqësore janë vërtetuar pretendimet e paditësit dhe atë në mënyrë të

pakontestueshme se i njëjti në kohën dhe vendin e përshkruar në precizimin e padisë të datës 11.09.2024 i njëjti është penguar nga i paditurit S. Gj. dhe K. Gj.. I padituri S. Gj. me vendosjen e një rrethoje nga druri i ka uzurpuar një pjesë të sipërfaqes të cilën deri atë ditë e shfrytëzonte dhe e kishte në posedim paditësi M. D. Me vendosjen e kësaj rrethoje i padituri S. ua ka pa mundësuar kalimin kushërinjve dhe vëllezërve të vetë të familjes Gj., ndërsa në vend që ata të merreshin vesh si familje filluan ta shfrytëzojnë për kalim oborrin e paditësit M.D.dhe atë në distancë më me pak se 1 metër nga dera e stanit nëpër terasën ku ka qenë e vendosur një tavolinë që paditësi me familje e ka shfrytëzuar edhe për dreka në natyrë. Dëshmitarët H. Gj. dhe K. Gj., meqenëse duhet të jenë të pozicionuar njëjtë kanë dhënë dëshmi kontradiktore psh në faqen 5 rreshti i dytë i procesverbalit të datës 09.09.2024 H. Gj. deklaroi se nuk është në dijeni që gjëja paditësi e ka në shfrytëzim dhe posedim pjesën që është kontest i kësaj lënde, ndërsa për të njëjtën pyetje K.i e pohon këtë se paditësi është posedues. Nga dëshmia e H. Gj. kemi kuptuar se i njëjti të paditurin e ka vëlla dhe çudit fakti se pse ai nuk kalon nëpër pjesën e vëllaut të tij por ka dera e paditësit. Në këtë proces gjyqësor edhe pse nuk është arritur që saktë të precizohet kur është kryer akti i posedimit ne jemi të sigurtë që padia është brenda afatit ligjor qoftë atij objektiv apo edhe subjektiv. Pretendimet e palës së paditur se gjëja me 60-70 vite janë në posedim të vendit që është kontest lëndor ka rënë plotësisht poshtë çoftë për me dëshmitë e dëshmitarëve por edhe me shkresat lëndore të gjykatës. Ajo që mbetet e pazgjidhur është fakti se megjithëse për këtë çështje janë duke u zhvilluar dy procese mbi bazën e pengim posedimit në të njëjtën gjykatë, i njëjti sipas nesh K. Gj. ka hequr e fqinjët të tij paditësit M.D.se vazhdon të bie me makinë ka dera e stanit të të njëjtit. Për këtë ne i dorëzuam gjykatës edhe fotografinë ku shihet automjeti i K.it duke lëvizur. Sido që të jetë edhe nga dëshmia e dëshmitarit H.D.u informuam se palët të cilat kanë qenë gjithmonë në fqinjësi të mirë kishin arritur marrëveshje e të cilën pala e paditur nuk e ka respektuar, me këtë ka përfituar edhe me kohë për të shfrytëzuar të drejtën për të kontestuar afatet ligjore. Ashtu siç jemi deklaruar në fillim dhe kemi pritur sinqerisht deri në këtë seancë që kjo çështje të zgjidhej me marrëveshje ne shprehim keqardhje që një gjë e tillë nuk ka ndodhur dhe se paditësi tani është një situatë shumë të keqe që duke u mundur që të respektojë gjykatën dhe të pres vendimin e saj i duhet të durojë të paditurin që njëanshëm dhe me vetëgjyqësi të kalojë sa herë të dojë nga ana e stanit të tij nëpër tokën në të cilën është në posedim. Prandaj bazuar në të gjitha këto që u thanë me lartë kërkojmë nga gjykata që me aktvendim ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit dhe të sjellë aktvendim me të cilin obligohet pala e paditur që të mos e shqetësojë paditësin në pjesën në të cilën ai është në posedim.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar të specifikuara si në shumë prej 1.530,00 €.

I padituri në përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit ka deklaruar se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara dhe të pa argumentuara, për më tepër padia është e pasafatshme dhe si e tillë gjykatës i propozojmë që ta hudhë poshtë, arsyeja qëndron në faktin se rrethojat të cilat pretendon pala paditëse se i kanë vendosur palët e paditura, atë rrethoja të drurit janë vendosur qysh në vitin 2020, dhe nuk janë vendosur qysh pretendon paditësi në vitin 2023 përkatësisht me datë 27.08.2023, pra paditësi e ka lëshuar afatin 30 ditorë si afat ligjor tek rastet e tilla, dhe për këtë kemi prova dhe dëshmitarë që e vërtetojnë këtë fakt, e për më tepër janë vendosur në pronën e të paditurve të cilën pronë e kanë edhe në posedim të qetë faktik të pa shqetësuar nga askush tani e 70 vite. Andaj i ka propozuar gjykatës që për shkak të lëshimit të afateve ligjore dhe në mungesë të provave, fotografive, dëshmimeve e tjerë padinë e paditësit ta hedhë poshtë si të pasafatshme, respektivisht ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar. Tutje ka shtuar se me padi nuk na është bashkangjitur as edhe një provë e vetme në të cilat thirret paditësi, nuk qëndron po ashtu as pretendimi se të paditurit kanë hapur me eskavator dhe kanë rrafshuar bazamente në parcelën 253-37 ku paditësi pretendon se qenka në posedim të tyre, pasi që të paditurit e kanë shfrytëzuar pronën e tyre dhe pronat që i kanë në posedim tani e 70 vite, dhe kjo do të vërtetohet me dalje në vend dhe me dëshmitarë. Paditësi me asnjë provë të vetme nuk e ka argumentuar faktin se posedon ndonjë vendim të ish jugosllavisë siç pretendon se i është marrë prona kontestuese, e po ashtu nuk ka bashkangjitur as padi në të cilën thirret në të cilat thirret se e ka ushtruar vërtetimin e kësaj pronësie, edhe pse për ne është irelevante pasi prona ende figuron si pronë shtetërore. Madje paditësi ka kryer aktin e pengimit të posedimit duke ua mshelur edhe rrugën të paditurve pa bazë ligjore duke vendosur rrethoja tani duke vendosur edhe stan në rrugë, e ku rruga ka qenë gjithmonë e hapur për banorët dhe e shfrytëzuar nga familja Gj. me vite të tëra, pra ka qenë rrugë ekzistuese gjithmonë në shërbim të familjes Gj. dhe nuk mund të kuptojmë palën paditëse se çfarë interesi ka pasur dhe ka që të e pengon në posedim dhe shfrytëzim të qetë të pronës dhe shfrytëzim të rrugës palët e paditura kur i njëjti nuk ka pasur pronat aty asnjëherë, dhe këtë e di i gjithë fshati Kuqishtë përfshirë edhe vet paditësin, edhe për këtë ne kemi argumentuar me prova të mjaftueshme aktin e pengimit të posedimit të posedimit të kryer nga paditëse, e jo si në rastin konkret pala paditëse ka parashtruar padi pa asnjë provë të vetme, madje padia është e pasafatshme. Pra të gjitha pretendimet e paditësit janë supozime e aludime të pa mbështetura në asnjë provë që vërteton këto pretendime. Gjatë shqyrtimit ka deklaruar se mbetet pranë përgjigjes në padi, duke shtuar se i padituri S. kufizimin e pronës së tij që ka pasur në posedim dhe e ka kryer e ka kryer qysh në vitin 2020, ndërsa punimet se është punuar me eskavator dhe kanë hapur

rrugë pala paditëse nuk e ka argumentuar me asnjë provës cili nga të paditurit ka hapur rrugë po ashtu i padituri S. për datën për të cilën pretendohet se është kryer akti i pengim posedimit nuk ka qenë në Kosovë fare por në Amerikë. Nëse është fjala për një gropë të hapur ajo gropë është hapur para 1/5 e gjysmë dhe ka mbetur ashtu. Tutje ka shtuar se pala paditëse dhe i gjithë fshati Kuqishtë kanë dijeni se ajo rrugë gjithmonë është përdorë si servitut i kalimit të përhershëm për banorët respektivisht të paditurit të cilët kanë edhe mbi 10 shtëpi në atë zonë. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me administrimin e provave nuk është vërtetuar baza e kërkesëpadiisë dhe legjitimitetit pasiv i të paditurit, është vërtetuar se padia është e pas afatshme dhe nëse gjykata nuk e aprovon këtë kundërshtim atëherë me administrimin e provave në tërësi është vërtetuar pa bazueshmëria e kërkesëpadiisë. Rrjedhimisht mbesim në tërësi pranë parashtrësës së datës 06.11.202, 12.06.2024, 18.06.2024 dhe 29.09.2024, me propozim që kërkesëpadiia e paditësit të refuzohet si e pas afatshme përkatësisht si e pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe specifikuar në shumë 2.043,60 €.

III. Provat e administruara nga gjykata

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat si në vijim: një fotografi në orto foto, aktvendimi me numër 05-466/170/85 i datës 31.10.1986, aktvendimi me numër 309316/78 i datës 08.08.1978, vendimi me numër 309116, një kopje e planit për parcelën 253/37 e datës 03.12.1980, procesverbal i datës 23.09.1967, një fotografi e datës 17.09.2023, 5 fotografi të tjera të vendit të ngjarjes, një CD në të cilën shikohen 11 fotografi të pjesës kontestuese të datës 21.05.2006, ekspertiza gjeodezike e datë 03.06.2024 së bashku me skicën e matjes, orto-fotot dhe 6 fotografi të vendit të ngjarjes, kopje e planit, certifikata e pronës dhe raporti i njësisë kadastrale, një fotografi e stanit të palës paditëse, si dhe dëgjimi i dëshmitarëve K. Gj., H. Gj., H.D.dhe H. D.

IV. Vlerësimi juridik dhe faktik i gjykatës

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitën e nenit 8 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se parcela me nr. 253-1 dhe nr.253-37 me kulturë të përgjithshme Mal 1 evidentohet në emër të Pronë Shoqërore Ekonomia Pyjore 1/1, gjë e cila vërtetohet edhe përmes certifikatës e pronësisë.

Kontestuese ishte fakti se nga kush ishin vendosur rrethojat nga druri dhe në cilin vit ishin vendosur si dhe nëse i padituri kishte hapur rrugë me eskavator nëpër pjesën të cilën e ka në posedim paditësi.

Rezultojë të jetë fakt kontestuese edhe koha e kryerjes së aktit të pengim posedimit të pretenduar nga pala paditëse, ku ky i fundit pretendonte se ishte data 27.08.2023, kurse pala e paditur e ka mohuar këtë fakt.

Po ashtu, kontestuese ishte edhe se nga kush është kryer akti i pretenduar i pengim posedimit, ku pala paditëse fillimisht pretendonte se ishte kryer nga S. Gj., S. Gj., G. Gj., dhe më pas edhe K. Gj., ku ky fakt është mohuar nga pala e paditur, duke e kundërshtuar këtë fakt, madje duke theksuar se është këtu paditësi ai i cili ka kryer aktin e pengim posedimit ndaj të paditurve.

Pra si përfundim i krejt kësaj pjese, kontestuese ka mbetur koha e kryerjes së aktit të pengim posedimit, nga kush është kryer akti i pengim posedimit, mënyra e kryerjes së aktit të pengim posedimit dhe nëse pala paditëse kishte në posedim parcelën kadastrale objekt kontesti.

Nga administrimi i gjithmbarshëm i provave materiale dhe personale, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se pjesët e parcelave kur pretendohet të jetë i kryer akti i pengim posedimit, janë në posedim të palës paditëse, e ku në këtë pjesë i njëjti ka të ndërtuar një stan, kurse rrethoja e vendosur e për të cilën pretendohet të jetë kryer akti i pengim posedimit, është vendosur nga pikërisht pala paditëse (të cilin fakt e ka pohuar në seancën e daljes në vend – shih procesverbalin e daljes në vend). Tutje gjykata ka vërtetuar se i padituri S. Gj., nuk ka hapur asnjë rrugë në kohën e pretenduar nga pala paditëse apo edhe më parë, e nëpër pjesën të cilën e ka në posedim paditësi. Rruga që pretendohet se e ka hapur i padituri me eskavator nëpër pjesën të cilën e ka në posedim paditësi e të cilën e ka matur eksperti gjeodet në prezencë të palëve dhe gjykatës, në

fakt gjykata përmes daljes në vend ka vërtetuar se e njëjta është rrugë malore (trase) ku mezi shihen gjurmë të rrugës e cila shërben për qasjen në pjesët tjera të pronave të familjes Gj., mirëpo e rëndësishme është se gjykata me dalje në vend dhe me dëgjim të dëshmitarëve, nuk e ka vërtetuar se i padituri të ketë hapur këtë rrugë apo ndonjë rrugë tjetër nëpër pjesën në posedim të paditësit, e aq më tepër në periudhën e pretenduar dhe të ketë vendosur rrethojat në pjesën që e ka në posedim paditësi.

Me qëllim të konstatimit të saktë të gjendjes faktike, gjykata ka bërë daljen në vend së bashku me paditësin, të autorizuarin e paditësit, të autorizuarin e të paditurit dhe ekspertin gjeodet. Përmes kësaj gjykata ka vërtetuar se ngastra kontestuese 253-37 ZK Kuqishtë evidentohet në emër të Pronës Shoqërore – Ekonomia e Pyjeve dhe pjesa në të cilën shtrihet kontesti është pjesa veri – perëndimore e kësaj parcele, rruga e cila pretendohet që është hapur nga pala e paditur në terren është e pa mirëmbajtur e as nuk vrehen gjurmë të rrugës, por vetëm duket si një trase e hapur malore e mbuluar me hala të pishave. Kjo rrugë në pjesën hyrëse të saj është e mbyllur me rrethojë nga drunjtë ku hyrja fillon nga pjesa perëndimore dhe vazhdon në drejtim të lindjes e që po ashtu është e mbyllur me rrethojë druri e që dërgon tek disa stane tjera që sipas të paditurve janë stanet e familjes Gj., afër kësaj rruge që pretendohet gjendet stani i paditësit sipas pretendimit të tij dhe është e rrethuar me rrethojë druri dhe po ashtu sipas paditësit është ai që e ka rrethuar këtë pjesë të parcelës me rrethojë nga të gjitha anët. Rruga e pretenduar kalon përgjatë tërë pjesës së parcelës e cila në anën jug perëndimore është e mbyllur dhe nuk ka qasje në rrugën kryesore e që e njëjta është po ashtu e hapur në kuadër të parcelës 253-37. E njëjta është vetëm në terren dhe nuk është e regjistruar, dhe në pjesën lindore të kësaj rruge të pretenduar shihet se ka gjurmë të materialit guror-natyror.

Në prezencën palëve ndërgjyqëse është identifikuar pjesa në të cilën pretendohet se është kryer akti i pengim posedimit, ku në pjesën ku pretendohet të jetë kryer akti gjendet rruga që pretendohet se është hapur nga palët e paditura është e pa mirëmbajtur dhe nuk vërehen gjurmë të rrugës dhe afër kësaj rruge gjendet stani i paditësit sipas pretendimeve të tij dhe kjo parcelë në të gjitha anët e saj në pjesën të cilën e ka në posedim paditësi sipas pretendimeve të tij është e rrethuar me rrethojë të drurit, e po ashtu në prezencë të palëve është bërë edhe matja e pjesës së parcelës ku pretendohet të jetë kryer akti i pengim posedimit.

Palët në procedurë, nuk kishin vërejtje në konstatim e gjendjes faktike të bërë nga gjykata së bashku me ndihmën e ekspertit gjeodet.

Sic u tha, është bërë dhe marrje a provës me ekspertizë të gjeodezisë, ku eksperti gjeodet pasi që kishte bërë matjet në teren e në prezencë të palëve dhe gjykatës, ka dorëzuar raportin e tij me datë 03.06.2024. Përmes kësaj ekspertize, gjykata ka vërtetuar se çështja e objektit të kontestit kishte të bënte në parcelën me numër njësie 253-37 ZK Kuqishtë, e cila evidentohet në emër të Pronë Shoqërore Ekonomia Pyjore 1/1, por që në gjendjen faktike një pjesë e saj shfrytëzohet nga pala paditëse, parcelë kjo e cila shtrihet në territorin e Komunës së Pejës, përkatësisht ZK Kuqishtë. Parcela me nr.....sipërfaqen e përgjithshme eka $S=10400 \text{ m}^2$, me kulturë të përgjithshme Mal 1, dhe kjo parcelë kufizohet me parcelat fqinjë si: në anën veriore kufizohet me parcelat me numëre cila në kadastër evidentohet në emër të bashkëpronarëve: B.D.1/3, A.D.1/3 dhe D.D.1/3, 260-12 e cila në kadastër evidentohet në emër të TafëD.1/1, 260-38 e cila në kadastër evidentohet në emër të Q.Dresh 1/1, 260-52 e cila në kadastër evidentohet në emër të NuradinD.1/1, 260-99 e cila në kadastër evidentohet në emër të Ç.D.1/1, 260-100 e cila në kadastër evidentohet në emër të bashkëpronarëve: Ç.D.¼, A.D.¼, N.D.¼, dhe S.D.¼. Në veri – lindje, lindje, jug dhe perëndim përgjatë tërë vijës kufitare kufizohet me parcelën nr.253-1 e cila në kadastër evidentohet në emër të Pronë Shoqërore Ekonomia Pyjore 1/1. Sa i përket identifikimit dhe përshkrimit faktik i njëjti ka theksuar se bazuar në rrethanat dhe kushtet në terren (teren malor i pyllëzuar) dhe duke e pasur parasysh sipërfaqen e madhe të kësaj parcele është e pamundur që të identifikohet dhe të përshkruhet e tërë gjendja faktike në këtë parcelë. Tutje ka shtuar se në teren shihet se në kuadër të kësaj parcele ka shumë hapësira që shfrytëzohen nga banorët lokal, hapësirat janë të rrethuara dhe gjithashtu në të ka të ndërtuara shtëpi malore në etazhe të ndryshme (këta kufij faktik janë të materializuar me materiale të ndryshme nga druri dhe metali, ndërsa shtëpitë janë të ndërtuara në etazhe dhe prej materialeve të ndryshme), bazuar në faktin e lartcekur i njëjti është fokusuar vetëm në pjesën kontestuese. Po ashtu kjo pjesë është e rrethuar-thurur me kunja dhe copëza nga druri në lartësi prej 1.3 m nga të gjitha anët gjeografike, në kuadër të kësaj hapësirë në anën më qendrore është e ndërtuar një shtëpi malore prej druri dhe e mbuluar me llastër e në etazh P+0, pjesa tjetër jug-perëndimore pjesërisht është e pyllëzuar dhe drunjte halor (çetina), ndërsa pjesa tjetër veri-lindore dhe veri-perëndimore është e mbuluar kryesisht me bar dhe gurë natyror de shfrytëzohet si oborr i po kësaj shtëpie. Përveç një pjese në anën më veri-lindore të kësaj hapësirë nuk ka derë, qasja në këtë hapësirë nga rruga faktike e cila është edhe e asfaltuar krijohet vetëm duke e kapërcyer rrethojën nga druri. Sa i përket konstatimit për gjendjen faktik në terren, fillimisht është bërë identifikimi i gjendjes faktike, shikimi në vend. Bazuar në pohimin e palës paditëse është identifikuar dhe më pastaj është matur pjesa në të cilën pretendohet se është kryer akti i posedimit. Akti i posedimit

pretendohet se është kryer në brendësi të pjesës së rrethuar (kufi faktik i materializuar me kunjat dhe copëza nga druri) e cila në gjendjen faktike shfrytëzohet nga pala paditëse, e që kjo hapësirë e përbashkët shtrihet në kuadër të dy parcelave kadastrale me nr..... dhe të cilat evidentohen në emër të Pronë Shoqërore Ekonomia Pyjore 1/1, e që gjeografikisht shkrihet brenda pjesës së rrethuar dhe atë duke filluar nga perëndimi vazhdon në drejtim të lindjes për tu kthyer në veri, në këtë pjesë ka pak gjurmë e të cilat janë vështirë të identifikueshme bazuar në atë se kjo pjesë që pretendohet të jetë “rrugë e shtruar” në terren për nga përbërja është kryesisht e njëjte me pjesën tjetër të terrenit e në përbërje prej dheut, pjesërisht e mbuluar me gurë natyror, dushk nga drunjtë halor dhe bar dhe e njëjta situatë e krijuar në teren prezantohen përmes këtyre rasteve: Rasti I, ky rast e përshkruan hapësirën e përgjithshme prej Sip=380 m² (hapësirë kjo e kufizuar – rrethuar me rrethojë nga kunjat prej druri dhe copëzat poashtu prej drurit, që shfrytëzohet nga pala paditëse), e cila shtrihet në kuadër të parcelës 253-1, rasti II e përshkruan hapësirën e përgjithshme prej Sip=448 m², (hapësirë kjo e kufizuar – rrethuar me rrethojë nga kunjat prej druri dhe copëzat po ashtu prej druri, që shfrytëzohet nga pala paditëse), e cila shtrihet në kuadër të parcelës 253-37, rasti III përshkruan hapësirën në të cilën pretendohet se është kryer akti posedimit ka gjatësi prej 39.24 m, dhe gjerësi prej 4.5m, e në sipërfaqe të përgjithshme prej Sip=90 m², kjo pjesë shtrihet në kuadër të parcelës 253-1, përkatësisht në kuadër të hapësirës prej Sip=380 m², e që po ashtu shfrytëzohet nga pala paditëse, në rastin IV përshkruhet hapësira në të cilën pretendohet se është kryer akti i pengim posedimit, ka gjatësi prej 57.90 m, dhe gjerësi prej 3 m, e në sipërfaqe prej Sip=114 m², kjo pjesë shtrihet në kuadër të parcelës 253-37 përkatësisht në kuadër të hapësirës prej Sip=448 m² e që po ashtu shfrytëzohet nga pala paditëse.

Gjykata, kishte ftuar në sqarim ekspertin gjeodet, pasi që pala e paditur kishte vërejtje për përshkrimin e gjendjes faktike e përpiluar në ekspertizë, i cili në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 09.09.2024, kishte deklaruar se qëndroj në tërësi pranë ekspertizës gjeodezike të datës 03.06.2024 dhe kishte deklaruar se nuk kam asgjë më shumë për të shtuar përveç asaj që është thënë në ekspertizë, dhe se deklaratimet e dhëna në ekspertizë janë gjendja e fundit që evidentohet në kadastrë lidhur me pronësinë, e lidhur me dilemën e palës së paditur se përshkrimin që e ka bërë si rrugë nëpër pjesën ku e posedon paditësi ku e ka bazuar, saktësisht se a ka vërejtur gjurmë të automjetit në rrugë dhe se në cilën pjesë ka pas lëvizje dhe në cilën pjesë nuk vërehet që ka lëvizje të automjetit, i njëjti ka deklaruar se ky sqarim është i dhënë në ekspertizën në pikën C për konstatimin e gjendjes faktike. Ekspertizës së gjeodezisë gjykata ja fali besimin duke e vlerësuar si të punuar në mënyrë profesionale dhe e bazuar në shkresat e lëndës.

Me qëllim të vërtetimit sa më të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor, në seancën e datës 09.09.2024 procedoi dëshmitaret K. Gj. dhe H. Gj., ndërsa në seancën e datës 06.02.2024 procedoi dëshmitarët H. D, H.D.dhe H. D.

Dëshmitari H. Gj. ka deklaruar se: Gjithë fshati dhe familja jonë historikisht e kemi përdorur këtë rrugë gjithmonë e personalisht edhe unë, aty kemi kaluar me kafshë që i kemi quar në kullosa dhe i kemi kthyer prapa, gjithashtu jemi furnizuar edhe me dru për ngrohje, dhe kjo është që nga koha kur kam lindur ndoshta edhe më përpara dhe kjo është quajtur me termin V. që kanë tërheq vllaka e që si term nënkupton tërheqjen e drunjëve. Tutje ka shtuar se materiali ndërtimorë për ndërtimin e stanit të palës paditëse, gjithë materiali ndërtimor por edhe nevoja tjera familjare gjithmonë janë bartur vetëm për atë rrugë, me familjen e paditësit i njëjti ka deklaruar se asnjëherë nuk ka pasur problem për shfrytëzimin e kësaj rruge. Tutje ka shtuar se S., S. dhe G. Gj., nuk kanë hapur rrugë me ekskavator siç pretendon pala paditëse me datën 27.08.2024, dhe se sa është në dijeni për këto 20 vite askush nuk e ka shfrytëzuar dhe poseduar këtë pjesë. Paditësi diku para 20 viteve si dhe familjarët tanë kur ka filluar me e ndërtu këtë stan e kanë lutur që të mos e ndërtoj aty sepse na pengon, kurse këta kanë thënë se paska hapësire të mjaftueshme, dhe se nuk është stani i parë që është ndërtuar, ka deklaruar se nuk e mban mend që pjesa objekt kontesti ka qenë ndonjëherë e rrethuar. Tutje ka shtuar se këtë rrugë e kanë shfrytëzuar e gjithë familja Gj. duke filluar nga K.i, Luani, G.u, S.hu dhe S.i, dhe gardhi mes S.hu dhe M.it është vendosur në vitin 2020 edhe pse ka qenë gardh ekzistues por është zgjatur edhe pak. Me datë 27.08.2024 S., S. dhe G. Gj. nuk kanë qenë prezent në pjesën kontestuese dhe nuk e kanë porositur askënd që të hapin atë rrugë atë ditë.

Dëshmitari K. Gj. ka deklaruar se: Është në dijeni se afër stanit të M.D.kalon një rrugë, sepse nga ajo rrugë kam bartur materialin për shtëpi, dhe se ajo rrugë është e hapur prej se kam lindur unë dhe në atë rrugë kemi kaluar me kafshë. Me datë 27.08.2024 S., S. dhe G. Gj. nuk kanë qenë prezent në pjesën kontestuese dhe nuk e kanë porositur askënd që të hapin atë rrugë atë ditë. I njëjti ka deklaruar se shtëpia e tij ndodhet nën parcelën që është në posedim të paditësit, dhe në vitin 2003-2006 e ka bartur materialin për ndërtimin e shtëpisë. Me datë 27.08.2024 nuk ka punuar askush me eskavator nëpër pjesën që pretendohet se është rrugë. Zhavorrin apo gurt e thyer natyror të shtuar që vrehen të shtruar në një pjesë të kësaj rruge të pretenduar nuk i ka shtuar askush sepse është natyrale. Në kohën kur është bartur materiali për shtëpi nuk ka pasur gardh ekzistues. I njëjti ka deklaruar se pjesën rreth Stanit paditësi e ka në posedim por jo edhe rrugën.

Deklaratave të dëshmitarëve H. dhe K. Gj., gjykata i ka falë besimin pjesërisht, e vetëm sa i përket pjesës kur kanë deklaruar se i padituri nuk ka hapur rrugën e pretenduar me datë 27.08.2024 e as që ka porositur ndonjë person tjetër apo vendosje të rrethojës. Kurse sa i përket faktit se kjo pjesë nuk është në posedim të paditësit, gjykata nuk i ka falë besimin, pasi që me daljen në vend por edhe me deklaratat e dëshmitarëve H., H. dhe H. D. është vërtetuar se kjo pjesë është në posedim të paditësit.

Dëshmitari H.D. ka deklaruar se: Unë jam në dijeni se përbuzë stanit të M.it është hapur një rrugë por nuk e di se kush e ka hapur e cila përafërsisht është e hapur 1.5 deri 2 vite e më saktësisht nuk e di, e kjo rrugë të dërgon tek stanet e familjës Gj.. Kjo rrugë nuk të dërgon tek stani i S. Gj. i cili stanin e ka në një distancë 50-60 metra larg nga ky vend. Sa i përket çështjes së rrethojës unë e di se është një rrethojë se momentalisht nuk e di a ka sepse momentalisht nuk jetoj aty kur është vendosur nuk e di mirëpo mendoj që e ka vendosur H.ja ose dikush i familjes së tij. I njëjti ka deklaruar se në mes të stanit të M.it dhe S.hut ekziston një gardh për të cilin S.hu ka paguar punëtorë për ta vendosur, dhe ndoshta ka 2-3 vite që është vendosur dhe nuk e di se a ka pasur marrëveshje mes palëve që të vendoset. Gardhi i vendosur nuk i ka mbyllur qasjen në rrugë stanit të M.it po i ka mbyllur djemve të axhës së tij.

Dëshmitari H.D. ka deklaruar se: Stanin që po bëhet fjalë e kam ndërtuar unë, ndërsa në posedim e ka M.i, dhe asnjëherë nuk ka pasur rrugë përbuzë stanit të M.it, mua më kanë thënë që rrugën që po bëhet fjalë e ka qelë S.hu, kohën nuk e di, tutje shton se i kanë thënë që rrugën e ka qelur K.i por nuk e di kohën se kur dhe nuk e mban mend. Sa i përket rrethojës S.hu personalisht më ka thënë se e ka qit vet mirëpo kohën se kur e ka vendosur nuk e di por që kemi biseduar me S.hun dhe familjen e tij që të largohet ky gardh mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Tutje ka deklaruar se kur e ka ndërtuar stanin asnjë rrethojë nuk ka qenë aty.

Deklaratave të këtyre dy dëshmitarëve, gjykata u ka falë besimin pjesërisht, e sa i përket faktit se pjesa kontestuese është në posedim të paditësit, pasi që një gjë të tillë gjykata e ka vërtetuar edhe përmes daljes në vend. Sa i përket pretendimit se rruga është hapur nga S. Gj., një gjë të tillë dëshmitarët nuk ishin të sigurt dhe e kishin të dëgjuar nga të tjerët, mirëpo një gjë e tillë bie edhe në kundërshtim me atë që gjykata ka parë në teren, ku nuk është vërejtur ndonjë rrugë e hapur me eskavator. Po ashtu, sa i përket rrethojës së vendosur, kjo bie në kundërshtim edhe me

vetë deklarin e paditësit në seancën e daljes në vend, ku ka pohuar se ai personalisht e ka vendosur rrethojën.

Dëshmitari H. D. ka deklaruar se: M. i e ka një stan në fshatin Kuqishtë tek vendi i quajtur Liqenat të cilin e ka në posedim, e nga ajo që ka dëgjuar është se ka pasur një problem me S. hun për një gardh të cilat i ka dëgjuar nga bashkëfshatarët, dhe se gardhi në fjalë është i vendosur shumë afër stanit të M. it kurse kohën se kur është vendosur nuk e di por ndoshta maksimumi 3 vite. I njëjti deklaron se nuk e ka pa askënd duke e vendosur këtë gardh por se ka qenë një ditë në atë vend dhe e pa parë gardhin, ndërsa sa i përket çështjes së rrugës në brendi të oborrit në mes të stanit dhe gardhit i njëjti ka deklaruar se nuk ka rrugë.

Dëshmisë së dëshmitarit H., gjykata i ka falë besimin pjesërisht, sepse e njëjta përputhet edhe me atë që gjykata e ka vërtetuar përmes daljes në vend, e sa i përket vendosjes së gardhit, kurse sa i përket rrethanës se nga kush është vendosur i njëjti ka deklaruar se nuk ka dijeni, kurse sa i përket rrugës, ka deklaruar se nuk ka rrugë.

Në kontekst të kësaj, nga ajo që është vërtetuar edhe përmes daljes në vend, është jo kontestuese se paditësi e shfrytëzon objektin nga druri (stanin) për pushime verore, si dhe përmes ekspertizës gjeodezike është vërtetuar se hapësira objekt kontesti shfrytëzohet nga ana e paditësit.

Gjykata fillimisht sqaron se pala paditëse ka pretenduar se akti i pengim posedimit ka ndodhur me datën 27.08.2023, mirëpo një fakt i tillë sa i përket kohës është kontestuar nga i padituri, i cili në përgjigje në padi është deklaruar rrethojat që pretendon pala paditëse i ka vendosur pala e paditur, ato rrethoja janë vendosur qysh nga viti 2020, dhe nuk janë vendosur siç pretendon paditësi në vitin 2023, përkatësisht me datë 27.08.2023. Në këtë drejtim, pala paditëse nuk ka dorëzuar asnjë provë me qëllim të vërtetimit të këtij fakti, mirëpo vetëm e ka deklaruar se akti i pengim posedimit ka ndodhur me këtë datë. Gjykata palës paditëse por edhe të paditur, gjatë tërë procedurës së zhvilluar, i ka dhënë mundësinë që të propozojnë prova me qëllim të vërtetimit të fakteve të tyre, ku për një gjë të tillë i ka pyetur në seancën përgatitore si dhe në seancën për shqyrtim kryesor, pala paditëse kishte bashkangjitur disa prova, por të njëjtat nuk stadin e të provuarit për të vërtetuar aktin e pengim posedimit.

Po ashtu gjykata sqaron se pala paditëse fillimisht ka pretenduar se akti i posedimit është kryer nga S. Gj., S. Gj., G. Gj. e më pas duke hequr dorë nga të paditurit S. dhe G., e duke përfshirë

edhe K. Gj., i cili nuk ka dhënë pëlqimin që të jetë pjesë e kësaj procedure dhe gjykata e ka vlerësuar dhe ka refuzuar propozimin e palës paditëse që të lejohet zgjerimi i padisë në aspektin subjektiv ndaj të paditurit K. Gj., si dhe e ka konstatuar të tërhequr padinë në raport me S. dhe G. Gj., dhe çështja ka vazhduar me këtu të paditurin S. Gj.. Në këtë drejtim pala paditëse nuk ka arritur që të argumentoj se nga kush është kryer akti i posedimit, si dhe nuk ka ofruar dhe argumentuar me ndonjë provë se në çmënyrë dhe në cilën kohë është kryer akti i pengim posedimit pasi që nga neni 480 i LPK-së, përcaktohet, *kush, ku, kur dhe në ç 'mënyre e ka kryer aktin e pengimit të pretenduar e që kërkohet në kuptim të dispozitës së nenit 480 të LPK-së.*

Në bazë të nenit, 103 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore (LPDTS), parashihet se *“personi i cili e ushtron pushtet faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë “. Me nenin, 113 par.1 të këtij ligji është paraparë se “nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës “, ndërsa në paragrafin 2 të tij ceket se “nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi, mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore”*, e lidhur me nenin 111 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore (LPDTS) në të cilin shprehimisht parashihet se: *“Veprimet e kundërligjshme në posedim, personi i cili e privon nga posedimi poseduesin ose e pengon në posedim kundër vullnetit të poseduesit vepron kundërligjshëm, përveç nëse privimi ose pengimi lejohen shprehimisht me ligj, posedimi i fituar si rezultat i pengimit të kundërligjshëm është me të metë. Pasardhësi i posedimit tillë duhet të pranojë të metën e posedimit, nëse ai ishte në dijeni për të metën apo ai është trashëgimtar i poseduesit”*.

Në lidhje me çështjen në fjalë, duke u bazuar në nenin 480 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK), gjykata është kufizuar vetëm në konstatimin dhe provimin e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit, pa u lëshuar fare në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtën e posedimit, bazën juridike të posedimit, ndërgjegjshmerinë apo pandërgjegjshmerinë e posedimit.

Edhe pse sipas dispozitës së nenit 7.1 të LPK- së, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë provat me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa në dispozitën e nenit, 319.1 të LPK-së, parashihet se secila palë ndërgjyqës ka për detyrë të provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Gjykata duke vendosur lidhur me kërkesëpadinë e paditësve, pas administrimit të të gjitha provave dhe vlerësimit të tyre, së cilën veç e veç dhe të gjitha së bashku me lidhmëni me njëra-tjetrën, e duke u mbështeturën dispozitat e nenit, 7.1, 319.1 dhe 480 të LPK-së, e lidhur me nenin 103,111, 113 par. 1 dhe par. 2 të te Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore (LPDTS), erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar për faktin se paditësi, ka dështuar që të provojë faktin vendimtar, kohën e kryerjes së aktit të pengim posedimit, si dhe nga kush dhe në çfarë mënyre e ka kryer aktin e pengim posedimit, e që kërkohet në kuptim të dispozitave të lartcekura, e të cilin e ka pasur për obligim ta bëjnë në kuptim të dispozitave të nenit 7.1 e lidhur me nenin, 319.1 të LPK- së. Pra në rastin konkret pala paditës përpos me deklarime më asnjë provë të vetme nuk arriti që të argumentoj të drejtën e tij, sepse tek natyra e kontestit të pengim posedimit, koha e kryerjes dhe nga kush është kryer akti i pengim posedimit është një nga kushtet kryesore.

Bazuar në nenin 99.3 të LPK-së “Në qoftë se deklarata përmban ndonjë kërkesë, pala duhet në parashtrësë t’i tregoj faktet mbi të cilat e bazon kërkesën, *si dhe provat kur është nevoja për një gjë të këtyrë*”. Në këtë drejtim, pala paditëse ka pasë për obligim që të sjellë prova me të cilat do të i provojë faktet e saja të deklaruar në padi, e krejt kjo me qëllim të vërtetimit të këtyre fakteve të cilat i ka cekur, mirëpo në rastin konkret paditësi, me provat e administruara gjatë shqyrtimit kryesor nuk arriti të argumenton bazën e kërkesëpadisë edhe pse ligjërisht si palë paditëse ka për detyrë ta bëj atë.

Gjykata duke vendosur lidhur me kërkesë padinë e paditësit e duke u mbështeturën dispozitat e nenit 7.1, 319.1 dhe 480 të LPK-së, erdhi në përfundim se kërkesë padia e paditësit është në tërësi e pa bazuar, *kush, ku, kur dhe në ç ‘mënyre e ka kryer aktin e pengimit të pretenduar e që kërkohet në kuptim të dispozitës së nenit 480 të LPK-së.*

Gjykata me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet e palës paditëse të theksuar përmes të autorizuarit të tij e të gjitha këto pretendime të theksuara në kuptim të pretendimeve në padi, mirëpo të njëjtat nuk qenë me ndikim për një vendim ndryshe, sepse në rastin konkret gjykata kërkesën e paditësit e ka shqyrtuar në kuadër të autorizimeve që parashihet në kuptim të dispozitës së nenit 480 të LPK-së, dhe duke u mbështetur në këtë dispozitë siç është theksuar edhe më lart gjykata duhet ta shqyrtoi kërkesën vetëm në konstatimin e të provuarit e fakteve të

gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë, dhe pas administrimit të provave ka ardhur në përfundim se pretendimet e palës paditëse janë në tërësi të pa bazuara.

Gjykata si prova materiale i ka administruar dhe një fotografi në orto foto, aktvendimi me numër 05-466/170/85 i datës 31.10.1986, aktvendimi me numër 309316/78 i datës 08.08.1978, vendimi me numër 309116, një kopje e planit për parcelën 253/37 e datës 03.12.1980, procesverbal i datës 23.09.1967, një fotografi e datës 17.09.2023, 5 fotografi të tjera të vendit të ngjarjes, një CD në të cilën shikohen 11 fotografi të pjesës kontestuese të datës 21.05.2006, por të njëjtat nuk kanë qenë relevante për çështjen, ashtu që gjykata nuk është lëshuar fare në elaborim dhe vlerësim të tyre.

Gjykata, në kontekst të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, është e obliguar që të kufizohet në të provuarit e asaj që palët prezantojnë në gjykata, e asesi nuk mundet të marrë rol aktiv për nxjerrje të provave, e me përjashtim në rastet e parapara me nenin 3.3 të LPK-së, ashtu që edhe gjendja faktike e vërtetuar, është në bazë të provave që palët i kanë prezantuar në gjykatë e me qëllim të vërtetimit të fakteve të pretenduara nga të njëjtit.

Po ashtu, gjykata ka vlerësuar dhe pretendimet e tjera të palës paditëse, ku si të bazuar i ka marrë pretendimet vetëm sa i përket posedimit të pjesës kontestuese nga pala paditëse, kurse pretendimet e tjera nuk i ka marrë të bazuara, ngase kanë dështuar që të provojnë se është pikërisht i padituri S.h, ai që ka hapur rrugën e pretenduar me eskavator në ditën e pretenduar dhe ka bërë rrethimin e pjesës kontestuese me një gardh.

Sa i përket pretendimeve të palës së paditur, të paditur që gjykata të hedhë padinë për shkak se e njëjta është e pas afatshme, një gjë e tillë është e pa bazuar, ngase në këtë rast pala paditëse ka pretenduar se akti i pengim posedimit është kryer me datën 27.08.2023, kurse padia është ngritur me datë 19.09.2023 e brenda afatit 30 ditor, ashtu që më pas gjykata është e kufizuar vetëm në vërtetim të faktit nëse akti i pengim posedimit ka ndodhur me këtë datë dhe në mënyrën dhe vendin e përshkruar.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452, dhe 463 pika 1 të LPK-së, pasi që pala paditëse e ka humbur kontestin, ndërsa pala e paditur, i ka kërkuar - specifikuar shpenzimet e procedurës dhe duke marrë për bazë suksesin e saj në procedurë i takojnë

shpenzimet dhe atë për përpilimin e përgjigjes në padi 104 €, për përfaqësim në 5 seanca të mbajtura (5 x 135 €) në shumën prej 675 €, dhe për një seancë të shtyrë pa fajin e të paditurit në shumë prej 67.50 euro e në total në shumë prej 846.50€, kurse pjesa tjetër e shpenzimeve është e pa bazuar.

Bazuar në nenet, 114 të Ligjit mbi Pronësinë dhe të Drejtat sendore nenit 103, 111, 113 par.1 dhe par. 2 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, nenit 480 të LPK-së, lidhur me nenin, 142.3 të LPK- së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2023:199081, C.nr.2759/23, Dt.19.02.2025

Gj y q t a r i:

Vegim Maloku

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes të kësaj gjykate.